



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 120/3 Prot.

Tiranë, më 26 . 03 . 2025

V E N D I M

Nr. 63 , Datë 26 . 03 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është regjistruar ankesa me nr. 10 Regj., datë 15.01.2025, paraqitur nga znj. R. D kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të djalit të saj të mitur D. D, për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “aftësisë së kufizuar”, të djalit të vogël, të moshës 3 vjeç e gjysëm.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, znj. D, në mes të tjerash informon se: “Jam nënë e dy fëmijëve, përkatësisht të moshës 13 dhe 3.5 vjeç. Djali i vogël është person me AK, për shkak të sëmundjes dhe diagnozës së përcaktuar nga KMCAP. Unë kam kujdestarinë e tij, pasi ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme.

Djali i madh është në klasën e shtatë, pranë shkollës 9-vjeçare “Doktor Haki Mbroja”, në fshatin Mborje. Në muajin tetor jam lajmëruar nga mësuesja kujdestare për të përgatitur dokumentacionin për përfitimin e bursës për djalin. Kam dorëzuar dokumentacionin e kërkuar dhe në muajin janar jam lajmëruar që djali nuk është përfitues i kësaj burse për shkak të mungesës së dokumentacionit (vërtetim si punëkërkuese e papunë), ndërkohë që unë kam kujdestarinë e djalit të vogël dhe nuk jam e regjistruar si punëkërkuese e papunë. Jemi familje që gëzoj statusin e “familjes në nevojë”, pasi trajtohem me ndihmë ekonomike. Nuk më duket e arsyeshme të skualifikohem për këtë dokument, ndërkohë që automatikisht çdo individ në moshë madhore dhe familja e tij përfiton

*ndihmë ekonomike (NE), është i regjistruar si punëkërkuës i papunë (kusht kryesor për dokumentacionin e përfitimit të NE).*

*Në familjen time kam dhe një fëmijë që gëzon statusin e invalidit. Nga ana e specialistëve të Bashkisë ky kriter nuk është marrë parasysh. Të ardhurat e mija janë të pakta dhe nën të ardhurat minimale për një jetesë normale për një familje me katër persona, një ndër të cilët me AK.”*

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për djalin e saj, D. D, nxënës që ndjek arsimin e detyrueshëm bazë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 120/1, datë 16.01.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - Informacion mbi arsyet se përse nuk është pranuar aplikimi/dokumentacioni i paraqitur nga pala ankuese për përfitimin e bursës për djalin e saj të mitur D. D.
  - Kopje të dosjes të dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja.
  - Informacion nëse fëmija e ankueses (D. D) ka përfutur vitet e kaluara pagesë burse. Nëse po, kopje të aktit/dokumentit provues.
- Me shkresën nr. 69, datë 23.01.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar në mes të tjerash se:

*“Znj. R. D ka kërkuar bursë për fëmijën e saj, D. D, nxënës në shkollën “Doktor Haki Mbroja”. Sipas informacionit nga Drejtoria e shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë kësaj drejtorie. Nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe janë dorëzuar pranë Ndërrnarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është pranuar dhe është shqyrtuar së bashku me të gjithë dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.*

*Nxënësi D. D, nuk ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2024-2025, pasi me dokumentet që ka dorëzuar për aplikim nuk mund të klasifikohet në asnjë nga kriteret për përfitimin e bursës, sipas kriterit 2.3/d, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, sepse ka djalin e vogël me aftësi të kufizuara. Në këtë pikë thuhet shprehimisht: “Nxënës fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit” dhe dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë është:*

- *Certifikatë personale;*
- *Certifikatë familjare*
- *Vërtetim nga shkolla*
- *Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve;*
- *Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.*

*Bazuar në këtë pikë nxënësi D. D nuk mund të jetë përfitues i bursës sipas këtij kriteri, pasi mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar pranë nesh, asnjëri nga prindërit nuk gëzon statusin e invalidit.*

*Po ashtu nxënësi nuk mund të jetë përfitues edhe sipas kriterit ekonomik, pikës 2.1/c, pasi nuk ka paraqitur vërtetimet përkatëse.*

*Përsa i përket kërkesës tuaj në lidhje me faktin nëse nxënësi ka përfitur apo jo bursë vitin e kaluar, sqarojmë se nxënësi D. D nuk ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2023-2024”.*

2. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nenit 39, të Rregullores së Brendshme “*Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 29, datë 05.03.2025, të Komisionerit, në datën 13.03.2025, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, në kuadër të shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje<sup>2</sup>.

Gjatë takimit me përfaqësueset<sup>3</sup> e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua se:

- Dokumentacioni i kërkuar për përfitim të bursës, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nuk bazohet në asnjë akt shkresor të hartuar apo dalë nga ana e NSHMAÇ/Bashkia Korçë apo Bashkia Korçë, por është vendosur sipas interpretimit që Ndërmarrja, i ka bërë kriteret e kësaj VKM-je.

<sup>1</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

<sup>2</sup> “*Kopje të aktit ku është përcaktuar dhe miratuar lista e dokumentacionit që duhet të depozitohet një aplikant për përfitim të bursës.*

*A ka një procedurë të miratuar lidhur me mënyrën si realizohet shqyrtimi i aplikimeve për përfitim të bursave dhe afatet kohore? Nëse, po kopje të aktit/dokumentit përkatës ku është e përcaktuar procedura e shqyrtimit. Nëse nuk ka një procedurë të shkruar, informacion të detajuar se si realizohet në praktikë shqyrtimi i aplikimeve për bursë.*

*Kopje të urdhrit për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve për përfitim të bursave për vitin 2024-2025.*

*Si dhe çdo parashtrim e dokument, apo akt tjetër provues, që vlerësoni se ndihmon në sqarimin e problematikës së ngritur nga subjektet ankues.”*

<sup>3</sup> Znj. S. Z, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik, znj. K. Z, me detyrë Specialiste në Sektorin e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe znj. T. H, me detyrë Psikologe pranë NSHMAÇ.

- Nuk ka një procedurë konkrete të përcaktuar lidhur me shqyrtimin e trajtimin e dosjeve të aplikantëve për përfitimin e bursës, por nga praktika e krijuar prej tyre, kur gjatë shqyrtimit të dosjeve kanë konstatuar mungesë ose pasaktësi dokumentacioni, kanë kontaktuar verbalisht me drejtoritë e shkollave dhe u janë dhënë udhëzimet rast pas rasti, sipas specifikës të secilës dosje. Drejtoritë më pas kanë lajmëruar prindërit për plotësimin e dokumentacionit dhe u është lënë një afat i arsyeshëm për plotësimin e dorëzimin e tyre.
- Përgjegjësia për plotësimin e dorëzimin e dokumentacionit është e vetë prindit aplikant dhe nuk është përgjegjësi e Ndërmarrjes për ta siguruar, pavarësisht faktit nëse dokumentacioni disponohet nga institucionet vartëse të Bashkisë.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Subjekti ankues, pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në shkelje të pikës 2.3/d, të VKM-së nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, duke mos u trajtuar rasti i fëmijës të saj, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit të saktë *(duhet vërtetimi mbi statusin e invaliditetit të njërit nga prindërit, jo të vëllait)*. Kërkimi i subjektit ankues para KMD-së lidhet me konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për fëmijën e saj.

Në kontekst të legjitimitetit të ankueses kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Korçë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin (si entitet) për miratimin e dhënien e bursave.

Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë (Ndërmarrja), nuk gëzon legjitimitet pasiv për pretendimin e ankueses për diskriminim lidhur me mospërfitimin e bursës për fëmijën e saj, pasi nuk ka tagrin e miratimit të dhënies së bursës.

Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka Ndërmarrja, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të bursës, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e Ndërmarrjes dhe ndikimin që ato kanë pasur tek vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin/mosmiratimin e bursës. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin e dhënies së bursave është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga NSHMAÇ dhe e kufizuar në listën e aplikantëve përfitues, të përcjellë prej saj.

*Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankueses, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të saj nga ana e Bashkisë Korçë.*

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 1, të tij përcakton se: “Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse”.

Neni 9, pika 1.1/ç), i Ligjit<sup>4</sup>, përcakton se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës: ...ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre”.

Në nenin 24<sup>5</sup>, i Ligjit, përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, ndër të tjera dhe: “... Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike, janë përcaktuar në nenin 33, të Ligjit, duke parashikuar se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

- a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;
- b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;
- ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

.....

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimtimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.”

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

...4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa

<sup>4</sup> Referuar ligjit sipërcituar me nr. 139/2015, i ndryshuar.

<sup>5</sup> Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollë të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

...

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënie bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.”

VKM nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë....”.

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar faktin nëse fëmija i ankueses plotëson kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike, në zbatim të pikës 2.3/d, të VKM-së sipërcituar, si dhe, nëse skualifikimi i tyre (për pasaktësi në dokumentacionin e dorëzuar) është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

***Në analizë të legjislacionit, dokumentacionit dhe informacionit të depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:***

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për përfitimin e bursës për djalin e saj, D. D, për shkak të aftësisë së kufizuar të vëllait të tij (D. D).

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive

dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Procedura dhe dokumentacioni i përfitimit të bursës rregullohet sipas përcaktimeve të VKM-së VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”; të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022.

Nga ana e palëve na janë vënë në dispozicion në cilësinë e provës:

- Vërtetim nr. 449, datë 28.10.2024, i Shkollës 9-vjeçare “Dr. Haki Mborja”, Korçë, me anë të të cilit vërtetohet se D. D, është nxënës i klasës së VII-të pranë kësaj shkolle për vitin shkollor 2024-2025.
- Çertifikatë e gjendjes familjare e datës 14.10.2024.
- Çertifikatë e personale e fëmijës D. D, e datës 15.10.2024.
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, në të cilin vërtetohet se D. D (vëllai), trajtohet me paaftësi në shumën 14.565 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, në të cilin vërtetohet se R. D (nëna e tij), trajtohet me pagesë kujdestarie në shumën 11.652 lekë.

Sa më sipër, Komisioneri do të shqyrtojë këtë çështje në bazë të shpjegimeve të dhëna nga ankuesja në formularin e ankesës, dokumentacionin shoqëruar si dhe informacionit të dhënë nga Bashkia Korçë.

Në këtë kuptim, referuar VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, personat që kërkojnë të trajtohen me bursë, duhet të aplikojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, pranë Institucioneve Arsimore jo më vonë se muaji tetor dhe pranë Këshillit Bashkiak në fund të muajit dhjetor.

Në pikën 1, të VKM-së sipërcituar, përcaktohet se:

*“Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional”.*

Në pikën 2, të këtij vendimi përcaktohet se:

*“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:*

### 2.3 Kriteri joekonomik:

.....

*d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;*

.....

*4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.*

*5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar”.*

Referuar provave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga palët, si dhe kritereve të përcaktuara në VKM-në sipërcituar, për përfitimin e bursës së fëmijës D. D, bazuar në kriterin joekonomik, do të duhej që statusin e invalidit, (AK) ta gëzonte njëri nga prindërit, dhe jo një familjar tjetër (përveç prindit), siç është në rastin konkret vëllai i tij.

Neni 7 i LMD-së<sup>6</sup>, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara gjatë hetimit të ankesës rezultoi se fëmija i ankueses, D. D, nuk plotëson kriterin për të përfituar sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi asnjë nga prindërit e tij nuk gëzon statusin e invalidit.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nxënësi D. D nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Korçë.

---

<sup>6</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me trajtimin e rastit të nxënësit D. D. Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar (*aftësinë e kufizuar të vëllait*) nga subjekti ankues<sup>7</sup>.

*Lidhur me pretendimin tjetër të znj. D, për trajtim diskriminues në procedurën e ndjekur për përfitimin e bursës për djalin e saj, D. Di, për shkak të gjendjes ekonomike, Komisioneri konstaton se:*

- Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti ankues për përfitimin e bursës, rezulton se ajo ka paraqitur gjithë dokumentacionin që lidhet me provueshmërinë e aftësisë së kufizuar të djalit, D. D, vëllai i fëmijës aplikues (D. D), duke prezumuar kështu se plotësonte kriterin joekonomik, sipas pikës 2.3/d, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”; të ndryshuar.
- Nga verifikimi i akteve që ka dorëzuar<sup>8</sup>, nuk rezulton që znj. D të ketë depozituar dokumentacionin e kërkuar sipas kriterit ekonomik, (pikës 2.1/c, të VKM-së sipërcituar) pasi ajo nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara sipas këtij kriteri.

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi. Komisioneri nuk administroi nga pala ankuese, prova dhe fakte të cilat të dëshmonin se ajo kishte depozituar dokumentet e kërkuara sipas kriterit ekonomik, pikës 2.1/c, të VKM-së respektive. Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se në mungesë të provueshmërisë së deklarimeve verbale të ankuseses, ato nuk mund të merren si të mirëqena.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, Bashkia nuk mund të ngarkohet me detyrimin dhe përgjegjësinë e shqyrtimit të aplikimit të saj, bazuar në kriterin ekonomik, (*kriter i ndryshëm nga ai joekonomik për të cilin ka depozituar dokumentacionin që sipas saj ishte konform kriterit 2.3/d, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”; të ndryshuar*), përsa kohë vetë ankuesja, bazuar në aktet e dorëzuara, nuk ka pretenduar përfitimin e bursës bazuar në kriterin ekonomik, pasi nuk ka depozituar asnjë nga dokumentet e kërkuar për këtë kriter (*vërtetimi i përfitimit të ndihmës ekonomike, etj*).

Për rrjedhojë, në shpjegim të sa më sipër dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë.

<sup>7</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 57, date 12.03.2025, të KMD-së.

<sup>8</sup> Referuar inspektimit të kryer nga KMD, pranë NSHMAÇ/Bashkia Korçë, me datë 13.03.2025.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Korçë, ardhur për shkak të gjendjes ekonomike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,  
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësit D. D<sup>9</sup>, për shkak të aftësisë së kufizuar të vëllait, dhe për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>9</sup> Përfaqësuar nga nëna, znj. R. D